



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, 17, 24 dhe 40, paragrafi 2, pika (b), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të dispozitave të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Nr-03/L-049, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-27/2008,” e konform nenit, 28, paragrafi 2, pika (b), 29, paragrafi 2, pika (c) dhe 56, të Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë2023, miratoi këtë:

Draft- V E N D I M

Për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin 2022 shuma prej 487,135.14€ të barten për shfrytëzim në vitin fiskal 2023

Neni 1

1.1 Komuna e Suharekës gjatë vitit 2022 ka tejkaluar planin buxhetor të të hyrave vetanake për pjesën e inkasimit të denimeve nga gjykatat, trafikut dhe pyjeve në shumë prej 182,779.44€.

1.2 Në vitin 2022, të hyrat vetanake kanë qenë të planifikuara, **2,054,989€**, ndërsa gjatë tërë vitit fiskal 2022, janë grumbulluar gjithsej shuma prej **2,237,768.44€**.

1.3 Mjetet e grumbulluara si tepriçë prej **182,779.44€** dhe shuma e pa shpenzuar që duhet bartur në vitin fiskal 2023 prej **304,355.70€** e si total i bartjes është shuma prej **(182,779.44€+(plus) 304,355.70€)=487,135.14€** shuma në fjalë duhet të bartet në programin SIMFK-së, dhe të lejohet për alokim dhe shpenzim në këto programe dhe kategori ekonomike.

Tabela 1.

Programet/nënprogramet	Mallra dhe Sherbime	Shpenzimet Komunale	Subvencione dhe Transfere	Invstime Kapitale	TOTAL:
Administrata (16312)	10,000.00		-		10,000.00
Sherbimet Publike dhe Emergjente (18012)	-	5,542.00		454,266.81	459,808.81
Planifikim e Urbaniz. (66365)	5,109.36				5,109.36
Shëndeti primar-QKMF (73750)	-			5,000.00	5,000.00
Administra e Arsimit (92060)		6,216.97			6,216.97
Kultur Rini e Sport (85012)			1,000.00		1,000.00
TOTAL:	15,109.36	11,758.97	1,000.00	459,266.81	487,135.14

Projektet kalitale sipas njësive buxhetore për bartje nga fondi burimor (22) në vitin fiskal 2023

Tabela 2.

Nr.	EMRI I PROJEKTIT	Bartja 2022
	Sherbimet Publike dhe emergjente - Infrastrukturë rrugore :	454,266.81
1	50659 Ndertimi dhe rregullimi i varrezave në qytet - Suharekë	220,777.37
2	52023 Ndertimi dhe rregullimi i Kolektorit ne rrugen "Skenderbeu"- Suharekë	83,989.44
3	52364 Ndertimi i rrugëve lokale "BUNARI I LIMANIT" DHE "FEHMI MORINA"- Vazhdim në SAMADRAXHE	31,500.00
4	52533 Ndertimi dhe sanimi i rrugëve lokale "SOPIJE-VRANIQ" DHE "REQAN-BUKOSH"	118,000.00
	Shërbimi i Kujdesit Primar (QKMF) :	5,000.00
1	50507 Blerja e paisjeve dhe montimi i sistemit të menaxhimit të radhës QKMF	5,000.00
	TOTALI :	459,266.81

Neni 2

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

Neni 3

Pas hyrjes në fuqi të këtijë vendim i njeiti do të shërbej për bartjen dhe alokimin e mjeteve vetanake të mbetura pa u shfrytëzuar nga viti 2022, e të cilat do të barten dhe shpenzohen në vitin fiskal 2023.

K U V E N D I I K O M U N Ě S – S U H A R E K Ě

01-Nr- _____
Më datë _____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI